

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Drejtor Ekonomik dhe i Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – kategoria: II-b

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

- **1 (nje) Drejtor Ekonomik dhe i Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë – kategoria: II-b**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë..

PËR TË DYJA PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

14/12/2020

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

18/12/2020

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

- Të ndjekë në vazhdimësi zbatimin e disiplinës dhe etikës në punë, konform Rregullores së KLP dhe legjislacionit për shërbimin civil dhe kodin e procedurave administrative, dhe, në rast shkeljeje, të marrë masa konform këtij legjislacioni.
- Të ndjekë ecurinë e përsosjes së strukturës organizative të stafit, të përgatisë projektin e organogramës dhe të organikës së KLP.
- Të ndjekë procesin e përcaktimit të kriterëve për klasifikimin e vendeve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të hartojë, në bashkëpunim me sekretarin e Përgjithshëm, shërbimet, drejtoritë dhe sektorët përkatës, kriteret për pranimin në shërbimin civil, ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele, si dhe vlerësimin e rezultateve të punës gjatë periudhës në provë dhe në vazhdim.
- Të sigurojë që informacioni mbi personelin është rifreskuar dhe aktualizuar vazhdimisht.
- Të plotësojë me saktësi dhe sistematikisht dokumentacionin mbi marrëdhëniet e punës, në përputhje me legjislacionin përkatës.
- Të organizojë punën për shpalljen e konkurseve për pranimin në shërbimin civil, ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele, si dhe të organizojë dhe të ndjekë gjithë procedurën e konkurrimit, konform legjislacionit të shërbimit civil.
- Të koordinojë aktivitetet për vlerësimin e nevojave të stafit dhe të hartojë dhe zbatojë veprimtari trajnimi për nëpunësit e stafit të KLP.
- Të ndjekë vlerësimin vjetor të rezultateve individuale të punës për nëpunësit civilë dhe, para vendosjes në dosjet personale, njoftimin e nëpunësve për vlerësimin e bërë nga eprorët, zbatimin e sistemit të pagave dhe të shpërblimit për punonjësit e administratës dhe të përpilojë dhe vendimet përkatëse për shpërblimet.
- Të japë mendim për zbatimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe të informojë personin ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore.
- Të bëjë në çdo fundviti vlerësimin për rezultatet në punë të punonjësve të shërbimit, si dhe të vendosë bashkërisht me ta objektivat për vitin pasardhës.
- Të sigurojë një administrim ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi për: menaxhimin e buxhetit, kontabilitetin, fiskal, atë të prokurimeve dhe çdo legjislacion tjetër që lidhet me veprimtarinë financiare të institucionit.
- Të sigurojë një administrim ekonomik sa më të mirë të vlerave monetare materiale dhe të përdorimit efektiv të fondeve dhe të bashkëpunojë me drejtuesit e shërbimeve të tjera për realizimin e buxhetit.
- Të hartojë planin ekonomik financiar të KLP, duke koordinuar punën me drejtoritë e KLP.
- Të ndjekë realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale, duke pasur për bazë fondin e buxhetuar nga Ministria e Financave dhe limitin buxhetor.
- Të ndjekë dhe të kontrollojë realizimin e kontratave në përputhje me çmimet dhe fondet e miratuara.
- Të përgatisë dhe të paraqesë evidencat periodike, sipas rregullave dhe normave në fuqi.
- Të organizojë dhe të kontrollojë punën për inventarizimin e pasurisë së KLP.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-b;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi; (të vërtetuar me dokument nga institucioni)
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Ekonomike, drejtimi “Financë”. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b. Të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën përkatëse në insitucionet e sistemit të drejtësisë, administratë shtetërore financiare.
- c. Certifikatë për auditimin e brendshëm në sektorin publik.
- d. Njohuri të mira të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass
- b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (6 mujori i pare i vitit 2020)
- h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Rr. “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë” ish. Fusha e Aviacionit, Tiranë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: **14/12/2020.**

Mos paraqitja e dokumentave të kërkuara përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15/12/2020**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë

kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverijes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2. NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar nga data 28/12/2020.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a ose III-a/1;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi; (të vërtetuar me dokument nga institucioni)
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Ekonomike, drejtimi “Financë”. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b. Të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën përkatëse në institucionet e sistemit të drejtësisë, administratë shtetërore e financiare.
- c. Certifikatë për auditimin e brendshëm në sektorin publik.
- d. Njohuri të mira të gjuhës angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass
- b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

- f. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (6 mujori i parë i vitit 2020)
- h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Rr. "Ana Komnena", Godina "Poli i Drejtësisë" ish. Fusha e Aviacionit, Tiranë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: **18/12/2020.**

Mos paraqitja e dokumentave të kërkuara përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28/12/2020**, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverijes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë");
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLP do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fazat e mëtejshme të kësaj

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duke filluar nga data: **28/12/2020**.